

Kopje e përkthyer vetëm për informacion. Pasi të jeni të kënaqur me informacionin e dhënë, ju lutemi plotësoni dhe nënshkruani formularin e miratimit të shkruar në gjuhën angleze dhe më pas kthejeni atë atje ku ndodhet fëmija juaj.

Talking Time© Studim Vlerësimi INFORMACION PËR PRINDËRIT DHE KUJDESTARËT E FËMIJËVE

Ne dëshirojmë të kërkojmë lejen tuaj për
të përfshirë fëmijën tuaj në (vlerësimin) e studimit *Talking Time* © (Koha e të folurit/ koha
e Bisedës)

Çfarë është studimi *Talking Time* ©

*Talking Time në shqip përkthehet si 'Koha e të folurit' apo edhe 'Koha e Bisedës'. Në vazhdim ne do t'i referohemi këtij projekti kërkimor në gjuhën angleze, pra Talking Time.

Shkolla ose çerdhja e fëmijës suaj po merr pjesë në një projekt duke përdorur programin *Talking Time* ©. *Talking Time* © përfshin aktivitete dhe lojëra të krijuara për të zhvilluar aftësitë e të folurit dhe të dëgjimit të fëmijëve. Këto aftësi janë të rëndësishme për t'i ndihmuar fëmijët të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë dhe të bëhen nxënës konfident dhe të suksesshëm.

Hulumtimet kanë treguar se *Talking Time* © punon për të mbështetur të folurin dhe dëgjimin e fëmijëve. Ne e dimë që fëmijët e vegjël i pëlqejnë aktivitetet dhe janë të etur për t'u bashkuar në to. Studimi ynë i ri synon të mësojë më shumë rreth ndikimit të *Talking Time* © në aftësitë gjuhësore të fëmijëve. Ai financohet nga Fondacioni Education Endowment (EEF), Fondacioni Nuffield dhe katër qendra praktike të viteve të vegjëlisë tek fëmijët (SPHs) (Rajoni i qytetit të Liverpool & Beyond, REACH Out, Thrive Together dhe A Brighter Start).

Do të marrin pjesë rreth 130 shkolla dhe çerdhe. Gjysma prej tyre do të marrin trajnime për t'i ndihmuar ata të përdorin *Time Talking* ©, duke filluar në Nëntor 2024 nga ku do të përdorin programin në çerdhe deri në qershor 2025. Gjysma tjetër (e shkollave dhe çerdheve) do të marrë një pagesë falënderimi, të cilën mund ta përdorë për të blerë më vonë materiale dhe trajnime për *Talking Time* ©. Shkollat/çerdhet e zgjedhura për të përdorur *Time Talking* © për këtë studim do të zgjidhen në mënyrë të rastësishme.

Nëse shkolla/çerdhja e fëmijës suaj zgjidhet për të përdorur programin *Talking Time* ©, fëmija juaj do të marrë pjesë në aktivitetet për të zhvilluar aftësitë e të folurit dhe të të dëgjuarit. Këto do të zhvillohen në grupe të vogla dy herë në javë për periudhën e pranverës dhe verës 2025. Aktivitetet do të drejtohen nga stafi i zakonshëm i fëmijës suaj, do të zgjasin rreth 15 minuta dhe do të zhvillohen gjatë kohës së rregullt të çerdhes/klasës.

Çfarë do të përfshihet për fëmijën tuaj?

Pavarësisht nëse shkolla/çerdhja e fëmijës suaj zgjidhet ose jo për të përdorur programin *Talking Time* ©, ne dëshirojmë të kërkojmë miratimin tuaj për të përfshirë fëmijën tuaj në tre pjesë të këtij studimi:

1. Vlerësime gjuhësore (të regjistruara me audio)

Ne dëshirojmë të kapim aftësitë gjuhësore të fëmijëve në klasën ose dhomën e fëmijës suaj duke përdorur vlerësime të shkurtra të bazuara në lojëra dhe figura.

Për shembull, ne mund t'i tregojmë fëmijës tuaj një fotografi të një 'gjarpëri' dhe t'i kërkojmë atij të emërojë objektin. Më pas do të regjistrojmë nëse fëmija mund ta identifikojë 'gjarpërin'. Për të kapur saktë gjuhën e fëmijëve, ne do të regjistrojmë audio-vlerësimet. Ne do ta mbledhim këtë informacion në të gjitha shkollat/çerdhet përpara se të fillojë *Time Talking*® (në Vjeshtë 2024) dhe përsëri në fund (në Verë 2025). Ne duam të shohim se sa përmirësohen aftësitë gjuhësore të fëmijëve në shkollat/çerdhet që përdorin *Time Talking*® krahasuar me ato që nuk e përdornin, për të parë se çfarë ndryshimesh janë bërë.



2. Regjistrimi audio i grupeve të tregimeve:

Ne gjithashtu do të donim të zbulonim nëse përdorni *Time Talking*

© ndryshon mënyrën se si stafi flet me fëmijët. Për ta bërë këtë, ne mund t'i kërkojmë stafit të çerdhes të regjistrojë veten duke lexuar dy tregime me një grup të vogël fëmijësh përpara se të fillojnë programin dhe përsëri në fund të programit. Ne do të krahasojmë regjistrimet për të parë se çfarë ndryshimi ka bërë *Talking Time*® (nëse ka bërë ndonjë ndryshim sigurisht).



3. Regjistrimet video të grupeve *Talking Time*:

Stafi që përdor *Talking Time*® do të ketë mbështetje nga një mentor ekspert. Si pjesë e kësaj, ata do të bëjnë video regjistrime duke udhëhequr tre nga seancat rutinë të *Talking Time*® me grupe të vogla fëmijësh në klasën/dhomën e tyre të përditëshme. Stafi do t'i diskutojë këto video me mentorin e tyre për të ndihmuar në përmirësimin e mënyrës se si ata mbështesin aftësitë e të folurit dhe të dëgjimit të fëmijëve. Videot do të përdoren gjithashtu për të mbështetur studimin duke zbuluar se si stafi e ofron programin.



Ne dëshirojmë ta përfshijmë fëmijën tuaj në vlerësim/studim dhe shpresojmë që ju t'i lejoni ata të marrin pjesë në vlerësimet dhe regjistrimet gjuhësore. Ju mund të jepni

pëlqimin (miratimin) për disa pjesë dhe jo për të tjera. Ju mund të bëni pyetje përpara se të vendosni nëse do të jepni miratimin tuaj.

Nëse jeni të lumtur që fëmija juaj të marrë pjesë : ju lutemi plotësoni formularin e miratimit bashkëngjitur kësaj fletëpalosje dhe kthejeni atë në shkollën/çerdhen e fëmijës suaj . Ju mund të jepni miratimin për disa pjesë dhe jo për disa pjesë të tjera. Për shembull, mund të jepni miratimin që fëmija juaj të marrë pjesë në vlerësime, por jo në regjistrimet audio të grupeve të tregimeve. Nëse jeni dakord, por ndryshoni mendje më vonë, mund të tërhiqni miratimin tuaj për pjesëmarrjen e fëmijës tuaj në çdo pikë të studimit, pa dhënë arsye. Për ta bërë këtë, kontaktoni shkollën/çerdhen e fëmijës tuaj ose ekipin e vlerësimit (të dhënat e kontaktit të tyre janë në fletëpalosjen e Pyetjeve me të shpeshta - të përfshira në këtë letër). Në formularin e miratimit, ekziston gjithashtu një pyetje se cilat gjuhë flisni ju dhe familja juaj në shtëpi. Ju lutemi na tregoni duke shënuar një nga kutitë.

Nëse nuk jeni të kënaqur që fëmija juaj të marrë pjesë : nuk keni nevojë të bëni asgjë. Zgjedhja për të mos dhënë miratimin tuaj nuk ka asnjë ndikim në kujdesin e zakonshëm që merr fëmija juaj, ose nëse shkolla/çerdhja përdor ose jo programin *Time Talking*® . Nëse ju nuk jepni miratimin tuaj, fëmija juaj do të vazhdojë të përfitojë nga aktivitetet e *Talking Time*® (nëse shkolla/çerdhja e tyre zgjidhet për të drejtuar programin), por fëmija juaj nuk do të marrë pjesë në vlerësimet/studimet dhe regjistrimet që do të kryhen.



Education
Endowment
Foundation



FORMULARI I MIRATIMIT TË PRINDIT/ KUJDESTARIT/ES SË FËMIJËVE

Ju lutemi merrni kohë për të lexuar deklaratat e mëposhtme.

Nënshkrimi i këtij formulari konfirmon marrëveshjen tuaj.

Kam lexuar dhe kuptuar fletën e informacionit, fletën FAQ (pyetjet e bëra më shpesh) dhe deklaratën e privatësisë.

Unë kam qenë në gjendje të bëj pyetje dhe jam i kënaqur me përgjigjet.



Unë e kuptoj pjesëmarrja e fëmijës tim në vlerësimet gjuhësore (të regjistruara me audio) dhe regjistrimet video dhe/ose audio të punës në grup është vullnetare dhe se unë mund ta tërheq miratimin tim për këtë në çdo kohë. E di që nuk kam nevojë të jap një arsye dhe se nuk do të ketë pasoja negative për mua apo fëmijën tim.



Unë e kuptoj se si videot që shfaqin fëmijën tim do të përdoren në trajnimin e stafit dhepo ashtu e kuptoj se si do të përdoren regjistrimet audio dhe video në vlerësimin e *Talking Time*®.



Unë e kuptoj se kush do të ketë akses në të dhënat e mia personale apo në të dhënat personale të fëmijës tim, si do të ruhen të dhënat në mënyrë të sigurt dhe çfarë do të ndodhë me të dhënat.



Unë e kuptoj se si të ngre një shqetësim ose të bëj një ankesë.



E kuptoj që mund të kërkoj që regjistrimet video dhe/ose audio të fëmijës tim të fshihen në çdo kohë (ose fytyra e fëmijës tim të turbullohet në video).



Shënoni mbi kutinë më poshtë për të konfirmuar miratimin tuaj që fëmija juaj të përfshihet në studim:

1. Unë konfirmoj pëlqimin tim që fëmija im të marrë pjesë në vlerësimin e këtij studimi, duke përfshirë vlerësimet gjuhësore	☐	Vlerësime gjuhësore (të regjistruara me audio)	
--	--------------------------	---	---

Nëse keni rënë dakord më lart që fëmija juaj të marrë pjesë në studim, ju gjithashtu mund të jepni pëlqimin tuaj për regjistrimet e tjera nëse dëshironi:

2. Unë konfirmoj miratimin tim që fëmija im të marrë pjesë në regjistrimet audio të grupeve të tregimeve	☐	Regjistrimi audio i grupeve të tregimeve	
3. Unë konfirmoj miratimin tim që fëmija im të marrë pjesë në video-regjistrimet e grupeve të Talking Time	☐	Regjistrime video të grupeve të Talking Time	

Cilat gjuhë flisni kryesisht ju dhe familja juaj në shtëpi? Ju lutemi, shënoni një kuti.

Vetëm ose kryesisht anglisht	☐	Vetëm ose kryesisht gjuhë(t) tjera. Ne flasim vetëm anglisht ndonjëherë ose nuk flasim fare anglisht.	☐
------------------------------	--------------------------	--	--------------------------

Një përzierje e anglishtes dhe gjuhëve të tjera, p.sh. gjysmë- gjysmë	☐	Preferoj të mos them	☐
---	--------------------------	----------------------	--------------------------

Konfirmimi i pëlqimit të prindit/kujdestarit:

Emri i shkollës/çerdhes: _____ Emri i fëmijës:

Emri i prindit/kujdestarit: _____ Nënshkrimi i prindit/kujdestarit :

Data: _____

**Thank you for taking the time to complete this form.
Please return it to a member of staff in your child's setting.**

Kopje e përkthyer vetëm për informacion. Pasi të jeni të kënaqur me informacionin e dhënë, ju lutemi plotësoni dhe nënshkruani formularin e miratimit të shkruar në gjuhën angleze dhe më pas kthejeni atë atje ku ndodhet fëmija juaj.